



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:273582

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05688342

KPPP.nr.868/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të “TEB” SH.A., me seli në rrugën ”Agim Ramadani” nr.15, ndaj debitorëve 1. “Creative 3D” SH.P.K., me numër regjistrimi të biznesit 81012769 me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Besim Morina, avokat nga Prizreni, 2. B.E. me vendbanim në Prizren, Medvec, me numër personal ..., 3. E.B. me vendbanim në Prizren, Medvec, me numër personal ..., 4. L.K.K., me vendbanim në Prishtinë rruga “Shaban Polluzha” nr.20, me numër personal ... dhe 5. V.K. me vendbanim në Prishtinë, me numër personal ..., duke vendosur sipas propozimit të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 635/21 të datës 11.11.2021 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani me seli të zyrës në Prizren, jashtë seance me datë 15.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar propozimi i “Creative 3D” SH.P.K., përfaqësuar nga E.B., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr. 635/21 të datës 11.11.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “TEB” SH.A ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 635/21 të datës 30.06.2021, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues Marrëveshjes mbi Pengun Nr.275445 dhe Nr.71086 të Marrëveshjes së Kredive dhe Mbitërheqjes, duke detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën prej 18,439.90€ (tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë euro e nëntëdhjetë cent) si dhe shpenzimet dhe tarifat e procedurës përmbartimore në të kundërtën realizimi i përmbartimit do të bëhet në mënyrë të dhunshme përmes llogarive bankare të debitorëve.

Debitori “Creative 3D” SH.P.K, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin ka kërkuar që urdhri përmbartimor të ndryshohet ashtu që të hudhet poshtë propozimi për përmbartim. Ka shtuar se për shkak të rrethanave të krijuara gjatë periudhës së pandemisë Covid 19, debitorët nuk kanë mundur që me kohë të realizojnë pagesën e detyrimeve duke propozuar që të mundësohet ri programimi i borxhit.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur kreditori, i cili ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke e konsideruar të njëjtin si të palejueshëm për shkak të mungesës së subjektivitetit dhe se është paraqitur vetëm me qëllim të zvarritjes së procedurës. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit të pabazuar dhe të lë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, rekomandimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*.

Gjykata vlerësoi se mbi bazën e Marrëveshjes së Kredive dhe Mbitërheqjes, kreditori me debitorët kishte lidhur Marrëveshje mbi Pengun Nr.275445 dhe Nr.71086, e cila marrëveshje është objekt i përmbartimit. Gjykata gjeti se marrëveshja e lartcekur nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht nuk i është bashkangjitur shkresave të lëndës në formë origjinale apo kopje të noterizuar, siç përcakton neni 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti*

nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.”, për më tepër në shkresa të lëndës mungon edhe vendimi mbi regjistrimin zyrtarë të pengut.

Në këtë drejtim, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: “*Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë*” gjykata erdhi në përfundim se urdhri për lejimin e përmbarimit duhet të anulohet, pasi që dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk kanë titull ekzekutiv.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike përmbarimore, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.868/22, datë 15.05.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.